

URDHËR
Nr. 19, datë 15.1.2020

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të nenit 56, kreut VII, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të mëposhtme të titullarit të Ministrisë së Kulturës, Sekretarit të Përgjithshëm, znj. Entela Çipa:

a) Të nënshkruajë autorizimet për përfaqësim ligjor të Ministrisë së Kulturës, në emër të personit që do të përfaqësojë ministrinë në të gjitha shkallët e gjykimit, duke përfshirë kërkesëpadi, kërkesë, shtim, pakësim, saktësim apo heqje dorë nga objekti i kërkesëpadisë, kundërpadi, ankim dhe rekurs kundër vendimeve të ndërmjetme dhe përfundimtare, kërkesë për pezullim, kërkesë për përjashtim gjyqtari, si dhe çdo kërkesë tjetër që ka lidhje apo del nga rrethanat e gjykimit të kësaj çështjeje. Përfaqësuesi i autorizuar nga Sekretari i Përgjithshëm, znj. Entela Çipa, i përcaktuar sipas kësaj pike, ka të drejtë të kryejë çdo veprim procedural përpara gjykatës, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, përveç rasteve kur kjo e drejtë kufizohet në aktin e autorizimit.

b) Delegimin e kompetencave të titullarit të autoritetit kontraktor, për të gjitha procedurat e prokurimeve publike me fonde buxhetore për Ministrinë e Kulturës.

c) Të nënshkruajë autorizimet për dërgim me shërbim të punonjësve të Ministrisë së Kulturës jashtë vendit.

d) Të nënshkruajë aktet lidhur me ankimet administrative drejtuar Ministrisë së Kulturës.

2. Këto kompetenca do të ushtrohen nga Sekretari i Përgjithshëm, znj. Entela Çipa, menjëherë me hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

3. Delegimi i kompetencave mbaron me revokimin e aktit të delegimit, si dhe pushimin e ekzistencës së organit delegues apo të deleguar.

4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, znj. Entela Çipa, si dhe të gjithë nëpunësit e Ministrisë së Kulturës për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I KULTURËS
Elva Margariti